



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr. ___ prot

5302/8

Tiranë më 24/12/2018

VENDIM

NR. 40 DATË. 04/12/2018
PËR

MOSMIRATIMIN E KËRKESËS PËR “MIRATIMIT NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE,NGA HEC BADRA SUBJEKTIT “RL INVESTMENT” SH.P.K.

Në zbatim të ligjit nr 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore” i ndryshuar, përkatësisht të nenit 42 pika 3; neni 50, pika 2, neni.52 gërma c; të VKM-së Nr.416 datë 13.05.2015“Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme ,dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimi për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore” si dhe të, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015 “ Për miratimin e rregullave dhe procedura ve të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, neni 24, gërma “f”, ndryshuar me VKM nr. 718 datë 12.10.2016 me propozim të A.B.U Ishëm Erzen për paisjen me autorizim miratim në parim të subjektit “**RL INVESTMENT**” SH.P.K. Keshilli i Basenit Ujor Ishëm Erzen ,

KONSTATOI SE,

Bazuar në shkresën Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura, ndërtimi i “Hec Badra ” sipas ligjit 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” është në zonë të mbrojtur në kategorinë “Peisazh i mbrojtur mali me Gropa Bizë, Martanesh ” (nënzona e përdorimit tradicional). Administrata e Zonave të mbrojtura është shprehur kundër miratimit të “HEC-eve” në zonë të mbrojtur.

Për këto arsye, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm - Erzen,

V E N D O S I:

1. Mosmiratimin e kërkesës “për miratimin në parim për përdorim të burimit ujor për energji elektrike nga Hec Badra subjektit “**RL INVESTMENT**” shpk” me administrator **Z. Erneo CANI**, për përdorim të burimit ujor duke shfrytëzuar rrjedhën e sipërme të lumit Erzen, përroi i Ganës, në fshatin Shëngjin bashkia Tiranë, qarku Tiranë me këto të dhëna

- Koordinatat e veprës së marrjes 1 X – 44 25 100 Y –45 76 720; Z- 700
- Koordinatat e veprës së marrjes 2 X – 44 24 760 Y –45 76 060; Z- 700
- Godina e centralit me koordinata : X- 44 22 520 Y- 45 77 210 Z- 570
- Prurja mesatare veprës së marrjes 1: Q mes 0.371 m³/sek;
- Prurja mesatare veprës së marrjes 2: Q mes 0.124 m³/sek;
- Prurja ekologjike:veprës së marrjes 1 Q₃₅₅= 0.016 m³/sek;
- Prurja ekologjike:veprës së marrjes Q₃₅₅= 0.005 m³/sek;
- Prurja që shkarkohet: Q_{llog}= 0.04 m³/sek.
- Fuqia e instaluar E= 490 KW

2.Kjo kërkesë nuk është miratuar për arsyet e mëposhtme:

- Shfrytëzimi i burimeve ujore të Hec Badra është në zonë të mbrojtur, në kategorinë “Peisazh i Mbrojtur, Mali me Gropa,Bizë Martanesh.

3.Ngarkohet ABU Ishëm-Erzen për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHEM -ERZEN

SEKRETAR

Dorina ÇAPUNI



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

